



Në bazë të nenit 5 pika 12, nenin 17 të Vendimit për stimuj dhe investime në zhvillimin e bujqësisë të Komunës së Tuzit (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi – Rregulloret komunale”, nr. 020/23 datë 27.04.2023) nenit 3 pika 4 të Programit të masave për realizimin e mjeteve për zhvillimin e prodhimit të bujqësore në Komunën e Tuzit për vitin 2024 - Agrobuxheti, nr. 02-016/24-2213/1 dhe Vendimit për rritjen e buxhetit për masat në mbështetje të zhvillimit të prodhimit të qumështit në treg dhe mbështetjen për përmirësimin e bletarisë, si dhe uljen e buxhetit për masën e pagesave direkte për njësi sipërfaqe për vitin 2024, nr. 06-06/24-2213/2 nga 09 09 2024 Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural publikon

THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE PËR PËRMIRËSIMIN E BLETARISË PËR VITIN 2024

DEFINICIONI I PËRFITUESIT

Përfitues I fondeve mbështetëse sipas kësaj Thirrje Publike janë njësitë bujqësore, të regjistruara në momentin e paraqitjes së Kërkesës për Dhënie të Mbështetjes, në Regjistrin e ekonomive bujqësore që mbahet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave, si dhe në Regjistrin e prodhuesve të mjaltit dhe produkteve të mjaltit të cilin e menaxhon Drejtoria për siguri të ushqimit, punë veterinarë dhe fitosanitare. Po ashtu përfituesit e mjeteve duhet të jenë anëtarë të shoqatës së bletarëve.

Mbështetja ka të bëjë me bletarë që banojnë në Komunën e Tuzit dhe të cilët kanë të paktën tre koloni bletësh.

LARTËSIA MBËSHTETJE

Mbështetje u jepet ekonomive bujqësore nga zona e komunës së Tuzit të regjistruara e që posedojnë së paku tre koloni bletësh deri në 15 euro për koloni bletësh. Shuma maksimale e mbështetjes për një fermë është 2.000,00 €.

Nëse shuma totale e kërkesave për pagesa mbështetëse tejkalon shumën e paraparë, pagesat për njësi reduktohen proporcionalisht. Për realizimin e kësaj masë me Programin e masave për realizimin e mjeteve për zhvillimin e prodhimit të bujqësore në Komunën e Tuzit për vitin 2024 - Agrobuxheti është parapa shuma prej 40.000,00 €.

DOKUMENTACIONI I DUHUR

Dokumentacioni i kërkuar për realizimin e kësaj mbështetje:

- kërkesa e plotësuar për dhënie të mbështetjes për përmirësimin e bletarisë për vitin 2024 (e cila është pjesë përbërëse e kësaj Thirrje Publike);
- dëshmi se janë të regjistruar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave, si dhe dëshmi se janë të regjistruar në Regjistrin e prodhuesve të mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit që mbahet nga Drejtoria për siguri ushqimore, veterinarinë dhe çështje fitosanitare;
- dëshmi se janë anëtarë të shoqatës së bletarëve
- dëshmi për numrin e kolonive të bletëve
- fotokopje e kartës së identitetit
- fotokopje e llogarisë rrjedhëse

SI TË DËRGONI KËRKESËN

Formulari i aplikimit për grantin e mbështetjes për përmirësimin e bletarisë për vitin 2024 (SHTOJCA I) mund të shkarkohet nga faqja e Komunës së Tuzit (www.tuzi.org.me) dhe në zyrën e Sekretariatit për Bujqësi dhe Rurale.

Formulari i plotësuar të aplikimit për grantin e mbështetjes për përmirësimin e bletarisë për vitin 2024 me dokumentacion shoqërues dorëzohet në arkivin e Komunës së Tuzit.

Kërkesa mund të dërgohet edhe me postë në adresën:

KOMUNA TUZI
SEKRETARIATI PËR BUJQËSIN DHE ZHVILLIM RURAL
RRUGA 1 NR 44
81206 TUZI

Informatat lidhur me këtë Thirrje publike mund të merren në numrin e telefonit: 020/ 875 167; 067/ 179 - 284 dhe 067/ 083 - 369.

Kohëzgjatja e Thirrjes Publike është nga data 10 shtator 2024 deri më 18 tetor 2024.

Përpunimi i kërkesave të pranura do të bëhet gjatë kohëzgjatjes së Thirrjes publike, ndërsa pagesa do të bëhet pas përfundimit të thirrjes publike dhe jo më vonë se fundi i vitit kalendarik.

PROCEDURA E REALIZIMIT

Para miratimit të stimujve financiarë, Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural viziton prodhuesit që kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë dhe inspektimin në vend, verifikon të dhënat dhe kushtet e përcaktuara në ftesën publike dhe përgatit një raport nga terreni për numrin e kolonive të bletëve që plotësojnë kushtet për përdorimin e stimujve financiarë.

Në rast se përdoruesi nuk lejon ose pengon punën e anëtarëve të Sekretariatit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në terren, dhe në çfarëdo mënyre ndikon në punën e tij, kërkesa e paraqitur nuk do të miratohet.

Bazuar në dokumentacionin e bashkëngjitur dhe inspektimin në vend, Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural bën me dije se janë plotësuar kushtet për ushtrimin e të drejtës së fondeve stimuluese dhe me vendim miraton pagesën e stimujve monetarë për përfituesit.

VEREJTJE

Aplikanti është përgjegjës për saktësinë e të dhënave dhe dokumentacionit për ushtrimin e të drejtës së mbështetjes.

Komuna e Tuzit, Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural rezervon të drejtën që para pagesës të verifikojë realitetin dhe vlefshmërinë e kostove të paraqitura, si dhe të iniciojë një kontroll financiar të të gjitha faturave në hyrje me autoritetet kompetente;

Nëse në procesin e verifikimit financiar të realitetit dhe vlefshmërisë së shpenzimeve të treguara, konstatohet nga autoritetet kompetente se përfituesi i fondeve në çfarëdo mënyre ka mashtruar ose ka çuar në përfundim të gabuar përgjegjësit për ndarjen e mbështetjes, ai është i detyruar të kthejë fondet mbështetëse që janë përdorur për qëllime të papërshtatshme, të shtuara me shumën e kamatës së vonesës.

Dokumentacioni i dorëzuar jo i plotë dhe i parakohshëm nuk do të merret parasyh.

SEKRETARJA

Ismeta Gjoka

